



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit/ Specializim Banka dhe Financa
Titulli i lëndës:	Mësimi praktik dhe zhvillimi i karrierës
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II (sem. III)
Numri i orëve në javë:	0+2
Vlera në kredi – ECTS:	2
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrim i lëndës	Mësimi Praktik dhe Zhvillimi i karrierës është lëndë e rëndësishme për studentët e vitit të dytë të studimeve Master të Fakultetit të Biznesit në drejtimin Banka Financa. Lënda u ndihmon studentëve të marrin njohuri bazë për punën praktike dhe zhvillimin e karrierës profesionale në institucione financiare sic janë bankat dhe institucionet mikrofinanciare, e po ashtu edhe në biznese në përgjithësi. Mësim praktik bën ndërlidhjen me aplikimin e pjesës teorike në praktikën profesionale dhe trajnimin në organizim dhe menaxhim, kontabilitetin, financën dhe auditimin. Lënda shtjellon teoritë e zhvillimit të karrierës; burimet dhe sistemet e shpërndarjes së informacionit arsimor profesional dhe personale/sociale; dhe po ashtu studiohet organizimi, menaxhimi dhe planifikimi i programeve të zhvillimit të karrierës.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i këtij programi është që t'i japë studentëve të Masterit, një sërë njohurish themelore në punën praktike në Institucionet Financiare dhe Institucionet Mikrofinanciare, por edhe në biznese sidomos në fushën e financave, kontabilitetit dhe auditimit, duke bërë kështu lidhjen me aplikimin e pjesës teorike në praktikën profesionale, dhe përgatitjen për aftësimin e kadrove të reja për tregun e punës në vendin tonë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Njohuri (NJ): *NJ1: Punimi i praktikës profesionale zhvillohet në banka, respektivisht në Institucionet Financiare dhe Mikrofinanciare apo edhe të njësitë tjera ekonomike në departamentin e

	financave dhe është e obliguar për çdo studentë. *NJ2: Studentët janë të obliguar të raportojnë mbi praktikën profesionale se në cilin Institucion Financiar/Mikrofinanciar apo në cilën Njësi ekonomike janë caktuar të mbajnë punën praktike. *NJ3: Studentët janë të obliguar të mbajnë ditarin e praktikës profesionale dhe i njëjti të vërtetohet nga mbikqyrësi i tij. *NJ4: Studentët janë të obliguar të vërtetojnë "Vlerësimin e studentit" nga Njësia ekonomike ku mbajnë praktikën profesionale dhe të njëjtin të sjellin në zarfë të mbyllur me rastin e mbajtjes së provimit . *NJ5: Qëllimi i orëve të Praktikës profesionale studentit do t'i ndimjoj në zbatimin e pjesës teorike të cilën e ka mësuar gjatë studimeve të zbatoj në praktikë me qëllim të aftësimit profesional të tij. *NJ6: Për një përvetësim më të mirë të lëndës kërkohet një angazhim direkt i konsiderueshëm i studentëve në orët e leksioneve, në orët e seminareve dhe në punën jashtë Fakultetit. *NJ7: Për të ndihmuar studentët për punën praktike e kanë të lirë komunikimin me profesorin e lëndës nëpërmjet përdorimit të postës elektronike si dhe në kontakte direkte , konsultimet. Aplikim-Kompetenca (A-K): **A-K1: Të arrihen objektivat në aftësimin e studentëve me njohuri teorike dhe praktike në lidhje me administrimin dhe menaxhimin e financave, kontabilitetit dhe auditimit në Institucionet Financiare/Mikrofinanciare dhe njësitë tjera ekonomike. **A-K2: Për t'iu krijuar mundësinë e planifikimit në procesin e hartimit të teknikave dhe të përgatisin raportet në lidhje me rezultatet dhe konkluzionet e këtij procesi.
--	---

	A-K3: Për të qenë të gatshëm dhe të aftë që të ofrojnë sigurinë e kërkuar nga objektivat e Institucioneve Financiare (Bankave) dhe Institucionet Mikrofinanciare, apo edhe bizneseve dhe shoqërive tregëtare në lidhje me informacionin në fushën e drejtimit planifikimit, financave dhe kontabilitetit dhe për një vendimëmarje efektive. **A-K4: Studentët marrin njohuri bazë në praktikën profesionale të cilët janë të detyruar të bëjnë në Banka dhe njësit e ndryshme ekonomike në departamentin e financave. Aftësi (A): *A1: Aftësimi i studentëve me këto njohuri teorike dhe praktike e në lidhje me Mësimin praktik për t'iu krijuar mundësinë për të qenë të gatshëm dhe të aftë, që të ofrojnë shërbimet e kërkuara në administrim, me qëllim plotësimin e nevojave të menaxhimit në lidhje me dhënien e sigurisë, për proceset e përpilimit të raporteve financiare, procese operacione, ruajtjes së aktiveve dhe zbatimin e legjislacionit, rregullave dhe udhëzimeve. ***A2: Të kuptojnë rëndësinë e procesit të planifikimit dhe përgatitjes së raportit të Punës së Mësimi Praktikë dhe të realizojnë një proces të Pasqyrave financiare. ***A3: Marrja e këtyre njohurive rritë mundësitë e punësimit si menaxher në institucionet financiare dhe mikrofinanciare. Në departamentin e financave në institucionet tjera publike apo private, si kontabilistë, analist i kredive, auditor apo të punësuar si ekonomist. <i>Sqarim:</i> Rezultatet e pritura të syllabusit janë të përpiluara konform rezultateve të pritura të programit, në përputhje me standardet e AKA-së. *Njohuri (Nj) **Aplikim-Kompetenca (A-K) ***Aftësi (A)
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)	

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	0	0	0
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	5	5
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren			
Seminare/kollektive	1	5	5
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgatitja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			
Projektet, prezantimet ,etj	1	5	5
Totali			50
Sqarim: 1 orë = 25 ECTS kredi.			
Përshtatja e ECTS me orët totale: 50 orë ÷ 25 = 2 ECTS kredi.			
Metodologjia e mësimdhënies:	Zhvillimi i leksioneve (ligjëratave) - Leksionet do të zhvillohen me një ngarkesë prej 2 orësh në javë për një grup leksionesh me një zgjatje prej 45 minutash secili. - Ato do të zhvillohen duke përdorur metodën e mësimdhënies interaktive, projektin e tyre në videoprojektor për të mundësuar një efektivitet më të lartë të përvetësimit të njohurive nga ana e studentëve. - Pra studentët janë të lirë që të pyesin dhe të kërkojnë sqarime sa herë e gjykojnë të nevojshme dhe po ashtu Profesori synon që t'i përfshijë ata në trajtimin e problemeve të vecanta. - Leksionet do të zhvillohen si në drejtimin teorik ashtu edhe praktik me ilustrime me raste studimore , ushtrime të nivelit konkretizues, etj. - Qëllimi i leksioneve do të jetë dhënia e njohurive teorike për të përgaditur kështu		

	kushte për të punuar në praktik si dhe në përgatitjen e seminareve. • Studentëve do t'u ofrohet mundësia e marrjes përveç tekstit bazë dhe të një kopje te materialit të leksioneve të parashkruara në zyrën për zhvillim dhe karrierë në Universitet si edhe për të patur mundësi orientimi gjatë studimit të literaturës. • Një ditë në javë, pra pas përfundimit të mësimit mbahen konsultimet me studentët, gjithashtu studentët e gëzojnë të drejtën e komunikimit edhe përmes postës elektronike. • Në këtë lëndë do të kombinohen: • Ushtrime, diskutime në grupe dhe individuale / punën ekipore; internship në biznese përkatësisht në, departamente, institute, banka, dhe agjenci.										
Metodat e vlerësimit: Vlerësimi i studentit bëhet pasi që studenti gjatë semestrit ka akumuluar pikët me kryerjen e punës praktike nëpër institucione publike apo private. Dhe ky vlerësim vlenë (ruhet) në të gjitha afatet.	Nota përfundimtare bazohet në: <table> <tr> <td>Vijimi i rregullt dhe aktiviteti</td><td>10%</td></tr> <tr> <td>Prezantimet-detyrat:</td><td>30%</td></tr> <tr> <td>Vlerësimi –Punimit Semin</td><td>50%</td></tr> <tr> <td>Vlerësimi i Institucionit</td><td>10%</td></tr> <tr> <td>Total</td><td>100 %</td></tr> </table>	Vijimi i rregullt dhe aktiviteti	10%	Prezantimet-detyrat:	30%	Vlerësimi –Punimit Semin	50%	Vlerësimi i Institucionit	10%	Total	100 %
Vijimi i rregullt dhe aktiviteti	10%										
Prezantimet-detyrat:	30%										
Vlerësimi –Punimit Semin	50%										
Vlerësimi i Institucionit	10%										
Total	100 %										
Literatura											
Literatura bazë:	1. Dr. Nazmi Iballi "Analiza Financiare ne Auditim"., Kolegji AAB, Prishtine, 2019 2. Prof.Dr.Baki Koleci, Prof Neritan Turkeshi., Manaxhimi (Bazat e Menaxhimit), botimi i dyte, Kolegji AAB, Prishtine, 2014 3. Prof.Dr.Izet Zeqiri, "Menaxhmenti Strategjik, Krijimi i avantazhit konkurrues", Shkup, 2016 4. Prof.dr. Shefket Jakupi, Dr.Bedri Statovci, "Parimet Baze te Kontabilitetit", Prishtine, 2023										
Literatura shtesë:	1. Prof.Dr.Refik Kryeziu, "Financat Publike", shtepia botuese : Olymp, Prishtine, 2014 2. Bedri Statovci, Shefket JAKUPI, Auditimi i Avancuar ,Pejë ,2017 3. Prof.Dr.Ingrid Shuli, Prof.Asoc.Dr. Rezarta Perri, "Analiza e Pasqyrave Financiare", Universiteti i Tiranes, Tirane, 2016										

	Literatura e lartë shënuar u propozohet studentëve që të kenë bazë për të bërë punimet seminarike, pra që teorinë të ndërlidhin me punën praktike. 1. Manual for Practical Work of Students, UHZ. https://unhz.eu/manuali-per-punen-praktike/.
Plani i dizajnuar i ushtrimeve:	
Java	Ushtrimi që do të zhvillohet
Java e parë:	Tema: Hyrje në lëndën mësimi praktik Njohuri të përgjithshme. Pse është i domosdoshëm Mësimi praktik dhe praktika profesionale.
Java e dytë:	Tema; Përgatitja për aplikim për punë - Përgatitja e CV-së suaj profesionale - Përgatitja e letrave motivuese për karrierën dhe praktikën tuaj Shembuj të ndryshëm të përgaditjes së CV dhe letrave motivuese si dhe Hulimtim/Praktikë në Departamentin e MB.
Java e tretë:	Tema: Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi që kanë studentet gjatë semestrit në punën praktike Hulimtim/Praktikë në Departamentet, Institutet dhe Agjencitë, organizatat në Kosovë.
Java e katërt:	Tema: Konsultime dhe diskutime në ushtrime për punimet e punës praktike raste studimi me studentet e Gr I-rë dhe Gr II-të
Java e pestë:	Tema: : Konsultime dhe diskutime në ushtrime për punimet e punës praktike raste studimi me studentet e Gr III-të dhe Gr IV-të
Java e gjashtë:	Tema: : Konsultime dhe diskutime në ushtrime për punimet e punës praktike raste studimi me studentet e Gr V-Të dhe Gr VI-të
Java e shtatë:	Tema: : Konsultime dhe diskutime në ushtrime për punimet e punës praktike raste studimi me studentet e Gr VII-të dhe Gr VIII-të
Java e tetë:	Tema: Prezantimi i punimeve dhe përvojave gjatë procesit të punës praktike të punës praktike Gr I-rë
Java e nëntë:	Tema: Prezantimi i punimeve dhe përvojave gjatë procesit të punës praktike të punës praktike Gr II-të
Java e dhjetë:	Tema: Prezantimi i punimeve dhe përvojave gjatë procesit të punës praktike të punës praktike Gr III-të
Java e njëmbëdhjetë:	Tema: Prezantimi i punimeve dhe përvojave gjatë procesit të punës praktike të punës praktike Gr IV-të
Java e dymbëdhjetë:	Tema: Prezantimi i punimeve dhe përvojave gjatë procesit të punës praktike të punës praktike Gr V-të
Java e trembëdhjetë:	Tema: Prezantimi i punimeve dhe përvojave gjatë procesit të punës praktike të punës praktike Gr VI-të
Java e katërbëdhjetë:	Tema: Prezantimi i punimeve dhe përvojave gjatë procesit të punës praktike të punës praktike Gr VII-të

Java e pesëmbëdhjetë:	Tema: Prezantimi i punimeve dhe përvojave gjatë procesit të punës praktike të punës praktike Gr VIII-të
------------------------------	---

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.

VËREJTJE: Për çdo temë mësimore, studentët do të pajisen me materiale të nevojshme në gjuhën shqipe. Në fund të çdo ore mësimore, grupet e caktuara të studentëve do të angazhohen me detyrë apo rast studimi lidhur me punën praktike në teren respektivisht nëpër Njësi ekonomike. Rezultatet e arritura nga ajo detyrë, grupet e studentëve duhet t'i prezantojë dhe t'i diskutojnë ato në orën e ushtrimeve.

Vërejtje për studentin:

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore.
- Duhet të respektojë orarin e ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore.
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit apo ID kartelave në teste dhe provim.

Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.

SHËNIM:

- Pjesëmarrja në ushtrime
- Puna Praktike dhe ndarja grupore në raste studimi dhe detyra të caktuara.
- Pjesëmarrja në diskutime lidhur punën praktike dhe me rastet e studimit.